

SPECIFIKIME TEKNIKE

Projekti i rikonstruksionit te rrugeve te njesise administrative Luz i vogel te Bashkise KAVAJE





I. Paraqitje

Ky 'Specifikim Teknik', si dokument kontraktual, eshte hartuar enkas nga grupi i projektimit per projektin "Projekti Rikonstruksionit te rugeve te Bashkise Kavaje. Zerat e rradhitura ne permbajtje, jane pjese dhe pershkrime te detajuara te vizatimeve te bera nga projektuesit. Standartet e perdorura ne kete 'Specifikim Teknik', nuk kane qene mbeshtetur vetem ne vizatimet por dhe ne manualet ligjore dhe libra te tjere keshillues si:

- Manuali nr.1 i "Analizat Teknike per prodhimin e materialeve te ndertimit, udhezime dhe kriteret"

Tirane - Dhjetor 1992 (Republika e Shqiperise - Ministria e Ndertimit),

Projektimi i Betoneve te Zakonshme, K.T. 37-75,

Tirane - 1980 (Republika e Shqiperise - Ministria e Ndertimeve I.S.P.Nr. 1).

Raporte e meposhtme per betonin, perdorur ne punimet e ndertimit dhe referuar zerave specifike, jane te vleshme per 1(nje) m³ volum beton me çimento te zakonshme Portland. Këto standarte bazohen ne broshuren "Projektimi i Betoneve te Zakonshme, K.T. 37-75",

Tirane 1980(Republika e Shqiperise - Ministria e Ndertimeve I.S.P.Nr. 1)

Punime ne rruge



Shtrese cakulli makinerie 1x15 cm, gran.5/60 mm

Ky ze perfshin teresine e punimeve qe lidhen me shtresen e cakullit 1x15 cm me qellim perforcimin e trupit te rruges ne drejtimin terthor dhe gjatesor sipas profileve perkatese te projektit si dhe rulimin dhe ngjeshjen e shtreses se cakullit deri ne densitet 95%. Per shkak te gjendjes jo uniforme te siperfaqes egzistuese te rruges. Ne tere siperfaqen eshte parashikuar perdorimi i grejderit me qellim perpunimin me te mire te siperfaqes se rruges dhe rulimi i shtreses me rul 10- 12 ton me 5 – 6 kalime vajtje ardhje. Granulometria duhet te jete jo me shume se 5/60 mm, cakulli qe do te perdoret duhet te miratohet paraprakisht me shkrim nga perfaqesuesi i Investitorit dhe Supervizori.Ky material duhet te plotesoje kushtet teknike per qellimin e perdorimit dhe te mos kete me shume se 5% argjila.Ky cmim i reforohet 1 m2.

Shtrese stabilizanti 1x15 dhe 1x20 cm, gran.0/35mm.

Ky ze perfshin te gjitha proceset dhe materialet qe duhen per ndertimin e shtreses uniforme me trashesi 15cm te stabilizantit dhe vende vende 20 cm per mbushjen e gropave, pas perfundimit te shtreses paraardhese te themelit te rruges. Ne te perfshihet kostoja e blerjes se materialit, furnizimi, transporti, depozitimi shtrimi dhe nivelimi me grejder dhe cilindrimi me 5 – 6 kalime vajtje ardhje deri ne ngjeshje 98%. Stabilizanti duhet te jete nga thyerja e gurit te kavos me granulometri 0/35 mm, te behen provat e materialit qe perdoret per plotesimin e kushteve teknike, per materialin qe do te perdoret te lajmerohet perfaqesuesi i Investitorit. Vetem pas miratimit me shkrim nga Supervizori do te lejohet perdorimi i materialit te stabilizantit. Çmimi i referohet 1 m².

Shtrese binderi me trashesi 5 cm.

Ky çmim perfshin koston per blerjen e materialit, furnizimin, shperndarjen e binderit ne nje shtrese uniforme me trashesi 5 cm dhe cilindrimin e tij, pas perfundimit te shtreses uniforme e ngjeshur dhe profiluar mire dhe sipas projektit e stabilizerit ne te gjitha siperfaqen e rruges me makineri, si dhe pastrimi nga papastertite e mundshme qe te realizohet bashkimi i saj me shtresen e re. Para shperndarjes se binderit duhet te behet sperkatja e siperfaqes me prajmer 0,5 litra/m². Sasia e binderit duhet te jete e tille qe te siguroje pas rulimit trashesine minimale te percaktuar ne projekt (5 cm). Shtrimi duhet te behet me makine asfaltoshtruese. Binderit ne objekt duhet te kete granulometrine, temperaturen dhe konsistencen e duhur. Pas shperndarjes binderit duhet te rulohet duke krijuar nje siperfaqe konform prerjes terthore dhe pjerresive te dhena ne projekt. Pas rulimit behet pastrimi i siperfaqes se rruges nga mbeturinat. Anet e shtreses se binderit duhet te realizohen me ane te drejtuesve per te ruajtur linearitetin e tyre si dhe rrezet e kurbaturave ne kthesa. Ne kete çmim futet dhe çdo gje tjeter qe lidhet me kete operacion. Çmimi i referohet 1 m².

Shtrese asfaltobetoni me trashesi 3 cm.

Ky çmim perfshin koston e blerjes se materialit, furnizimin, transportin, shperndarjen dhe rulimin e asfaltobetonit ne nje shtrese me trashesi 3cm. Paraprakisht duhet te behet pastrimi i siperfaqes nga te gjitha mbeturinat. Para shperndarjes se asfaltobetonit duhet te behet sperkatja e siperfaqes me prajmer 0,5 litra/m². Sasia e asfaltobetonit duhet te jete e tille qe te siguroje pas rulimit trashesine uniforme minimale te percaktuar ne projekt (4 cm). Asfaltobetoni ne objekt duhet te kete granulometrine, temperaturen dhe konsistencen e duhur. Pas shperndarjes, asfaltobetoni duhet te rulohet duke krijuar nje siperfaqe konform prerjes terthore dhe pjerresive te dhena ne projekt. Shtrimi duhet te behet me makine asfaltoshtruese. Pas rulimit behet pastrimi i siperfaqes se rruges nga mbeturinat si dhe pastrimin i mbetjeve te asfaltobetonit mbi kuneten e betonit per te realizuar nje vije te dukshme. Ne kete çmim futet dhe çdo gje tjeter qe lidhet me kete operacion. Anet e shtreses se asfaltobetonit duhet te

realizohen me ane te drejtuesve per te ruajtur linearitetin e tyre si dhe rrezet e kurbaturave ne kthesa.Çmimi i referohet 1 m².

Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit territorit



